

PASHKO VASSA

Një nga detyrat e studiuesve të historisë së shqiptarëve mbetet, padyshim, të hedhin dritë mbi jetën dhe aktivitetin e personaliteteve të rëndësishme të historisë moderne shqiptare. Ndonëse në Shqipërinë komuniste është punuar për ndriçimin e disa prej personaliteteve shqiptare, sot kurrsesi nuk mund të thuhet se kemi një njohje të plotë të jetës dhe të aktivitetit të tyre.

Fakti që një pjesë e tyre ka qenë integruar në strukturat shtetërore dhe ushtarake të Perandorisë Osmane ka sjellë nga pas dy vështirësi deri më tani të pakalueshme. Së pari, njohja e jetës së tyre përgjithsisht është realizuar duke shfrytëzuar dokumentacionin perëndimor, dhe për pasojë ka mbetur e panjohur pjesa e jetës së tyre që ata kanë zhvilluar në Stamboll apo në vise të tjera të Perandorisë Osmane.

Në këtë kontekst, arkivat osmane marrin një peshë parësore. Nga jetëshkrimi i Pashko Vassës¹ që po bëjmë të njohur mësojmë se ku ai gjendej vit pas viti dhe nëpër çfarë ofiqesh kaloi karriera e tij në Perandorinë Osmane;² por, ky dokument bën me dije edhe se ku ai gjendej se në prag të zhvillimeve politike ndërkombëtare, zhvillime të cilat i paraprinë edhe ngjarjeve të mëdha në historinë moderne shqiptare.

Pashko Vassa është personaliteti që i pari hartoi një projekt historiko-politik për nacionalizmin shqiptar, i titulluar “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, botuar në vitin 1879. Eshhtë kjo vepër që i dha Pashko Vassës vlerësimin si ideologu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.³

Jemi të bindur se botimi i këtij dokumenti shënon veçse fillimin e procesit të një njohjeje më të plotë të personaliteteve shqiptare që mbartën mbi supë peshën e hartimit të doktrinës së nacionalizmit dhe të organizimit në terren të veprimit politik të nacionalizmit shqiptar.

¹ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi* (më tej: *BOA*) DH, SAID. 1/236.

² Studiuesi Vehbi Bala në studimin e tij monografik për Pashko Vassën shprehet me shqetësim se ka segmente të tëra apo edhe momente të rëndësishme të jetës së tij të cilat ishin krejt të panjohura dhe të padokumentuara në momentin kur ai hartoi këtë studim: *Pashko Vasa (portret - monografi)*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1979, f. 39.

³ Shih komentet e Mehdi Frashërit në: *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, shtypur në shtypshkronjën “Tirana”, 1935.

Jetëshkrimi

Pashko Vassa efendi* është i biri i Hil Vassës.** Lindi në Shkodër, sipas kalendarit Hixhri në vitin 1241/1825.

Në shkollat e Venedikut dhe të Romës ka mësuar [lëndët] shkencore: gjeografi, histori, arithmetikë, ekonomi, filozofi dhe jurisprudencë.

Lexon e shkruan turqisht, frëngjisht, anglisht, italisht, greqisht dhe sllavisht. Flet shqip, bullgarisht dhe pak arabisht. [Njohja] e këtyre gjuhëve, sipas kohës [kur i ka mësuar ato], është e dokumentuar me diplomat [përkatëse].

Ka një vepër italisht për rrethimin e Venedikut dhe informacione [sqaruese] rreth kësaj ngjarjeje. Ka disa libra të shkruara frëngjisht, [respektivisht] një për zhvillimet politike në Bosnjë-Hercegovinë dhe problemet e pronësisë së tokës atje; një përmbledhje për zhvillimet në Malin e Zi; në lidhje me Shqipërinë ka një vepër për gjendjen e shqiptarëve; dhe një studim [shkruar] turqisht që bën fjalë për të drejtën romake.

Në vitin 1266/ 1849-50, kur ishte vetëm 25 vjeç, u punësua pa pagesë në Zyrën e Përkthimit të Sarajit Perandorak. [Një vit më pas,] në vitin [126]7/ 1850-1, me një rrogë prej 500 groshësh, u emërua nëpunës përkthimi në Zyrën e Shëndetsisë.

Në vitin 1273/1856-7 kaloi në Shkodër si përkthyes në shërbim të administratës lokale osmane me një pagë mujore prej 1.000 groshësh; më pas, rroga iu ngrit në 1.500 groshë dhe [gjatë kohës që shërbente në Shkodër], shkoi dhe erdhi nga Cetina me ofiqin e zyrtarit [osman] që uroi kreun e Principatës së Malit të Zi, princ Nikollën, për shërim të shpejtë.

Në vitin [12]77/ 1860-1, gjatë Luftës me Malin e Zi, për herë të parë, u emërua anëtar i Këshillit të Luftës, me një rrogë mujore prej 1.500 groshësh dhe, me të njëjtën pagë mujore, përveç detyrës rutinë të përkthyesit, gjatë vitit [12]78/ 1861-2 kur Shkëlqesia e Tij, [Ahmet] Xhevdet Pasha, u dërgua me mision special në Shqipëri, kreu edhe detyrën e përkthyesit [të tij personal] dhe detyrën e sekretarit në gjuhën frënge. Në përfundim të luftës [me Malin e Zi], për verifikimin e gjendjes së mosmarrëveshjeve kufitare [mes Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane] shoqëroi gjeneral divizioni, Ali Pashën, dhe për një kohë, me dëshirën e tij, punoi në komisionin [përkatës] me shpenzime udhëtimi/dietë prej 5.000 groshësh.

Më pas, me një rrogë prej 2000 groshësh u caktua si përkthyes pranë divizionit ushtarak [osman] në Hercegovinë; kurse, në vitin [12]80/ 1863-4, me

* Në origjinalin osmanisht emri është shkruar në trajtën *Pasko*.

** Versioni i shkurtuar i emrit *Mëhill*.

një pagë prej 3.000 groshësh, u emërua mes inspektorëve [me kompetenca] të jashtëzakonshme për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe shërbeu në shpurën e Shkëlqesisë së tij, Zija Pashës, në këtë moment vali i Adanasë (Anadoll), dhe më pas shërbeu edhe për dy vjet me radhë pranë të lartpërmendurit, Shkëlqesisë së Tij, Xhevdet Pashës.

Në muajin Xhemaziulevel të vitit [12]80/ 15 tetor – 12 nëntor 1863, me marrjen e gradës [së rangut] të tretë, vjen në Stamboll. Për një farë kohe punoi si stazhier në Zyrën e Korrespondencës [me vendet e] huaja.

Në vitin [12]82/ 1865-6, me një pagë mujore prej 2.000 groshësh, për herë të dytë, u emërua përkthyes në vilajetin e Shkodrës.

Në vitin [12]83/ 1866-7, me një pagë mujore prej 5.000 groshësh, u emërua në detyrën e zv.drejtorit për çështjet politike në vilajetin e Halepit/Siri. Në vitin [12]84/ 1867-8, me një rrogë prej 7.500 groshësh u emërua në detyrën e drejtorit të zyrës së lartpërmendur; kurse në muajin Rebiulevel të vitit [12]85/ 22 qershor – 20 korrik 1868 iu akordua grada e dytë e klasit special, dhe, me një pagë prej 4.000 groshësh, caktohet në detyrën e kryesekretarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në muajin Xhemaziulahir të vitit [12]86/ 7 shtator-6 tetor 1869, merr gradën e parë të klasit të dytë, dhe, me një pagë prej 7.500 groshësh, emërohet anëtar i Gjykatës Penale dhe Civile, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në vitin [12]92/1875, me një rrogë mujore prej 4.000 groshësh, emërohet anëtar i Zyrës së Krimeve pranë Gjykatës së Apelit; dhe po gjatë vitit të lartpërmendur, me një rrogë mujore prej 12.500 groshësh, u emërua kryetar i Komisionit të Reformave në Hercegovinë dhe sërish brenda atij viti, me një pagë mujore prej 10.000 groshësh, u emërua nëpunës [me cilësinë e] anëtarit pranë Komisionit për Mbledhjen e Taksave, që vepron në Bullgari, [komision që kryesohej] nga i nderuari, Sadullah Bej, aktualisht ambasador [i Perandorisë Osmane] në Berlin.

Në vitin [12]93/ 1876-7 u caktua nëpunës për borxhet pranë zyrës së ndihmës valiut të vilajetit të Manastirit.

Nisur nga vlerat dhe kapaciteti [i tij personal], në muajin Shaban të vitit [12]94/ 10 gusht - 8 shtator 1877, u emërua këshilltar në vilajetin e Kosovës, me pagë mujore prej 12.500 groshësh.

Në vitin [12]95 / 1878 emërohet komisar i Rodopeve Ballkanike me një dietë fikse prej 100 lirash dhe, brenda po këtij viti, me një pagë mujore prej 6.000 groshësh, u emërua anëtar i Këshillit të Shtetit, dhe më pas, si një detyrë shtesë dhe pa pagesë, iu dha drejtimi i zyrës së shtypit dhe botimeve.

Në muajin Ramazan të vitit [12]96 / 19 gusht – 17 shtator 1879, me një rrogë prej 10.000 groshësh, është emëruar këshilltar në vilajetin e Edirnesë, ku gjendet edhe në këtë moment.

*

Në muajin Shaban të vitit [12]94 / 10 gusht – 8 shtator 1877, në përfundim të luftës me Malin e Zi, në kohën që shteti rus i akordoi shkëlqesisë së tij, Abdi

Pashës, kordonin e madh të medaljes së *Shën Stanisllasit*; meqënëse [Pashko Vasa] ishte pjesë e shpurës së tij, atij iu dha po e njëjta medalje, por e klasit të tretë.

Nga të gjitha detyrat zyrtare ku ka shërbyer deri më tani është liruar përmes kalimit nga një detyrë në tjetrën ose kur e ka përmbytur afatin e kohës [në atë detyrë]. Për tre vjet u lirua nga detyrat [shtetërore] dhe mbeti pa rrogë. Vetëm se largimi nga posti i anëtarit të Gjykatës së Apelit, sipas vetë atij, mbeti i panjohur. Gjatë kryerjes së shërbimeve të lartpërmendura [asnjëherë] nuk është fajësuar/ nuk është bërë përgjegjës për ndonjë gjë; asnjëherë për të nuk ka pasur ndonjë procedim ligjor.

Më 15 Rebiulevel, viti [12]97 dhe 14 shkurt [12]95* / 26 shkurt 1880

Rroga e të lartpërmendurit, Vassa Pasha, në datën 2 të muajit Rebiulahir të vitit [12]97 / 13 mars 1880, përgjatë kohës së rregullimeve [administrative], u ul në 8.000 grosh dhe [më pas] si vlerësim për detyrat e ngarkuara, në datë 23 të muajit Xhemaziulevel të vitit [12]99/ 12 prill 1882, iu dha medalja *Mexhidije*, klasi i dytë; në datë 18 të muajit Xhemaziulahir të po atij viti/ 6 maj 1882, iu akordua [medalja *Mexhidije*] e rangut të lartë. Në datën 28 të muajit Nisan të vitit [12]99/ 10 korrik 1883, me një pagë mujore prej 20.000 akçesh dhe me titullin *vezir*, u emërua mutasarrif i [distriktit të] Maleve të Libanit, emërim që u ratifikua në datën 3 të muajit Rexhep të viti 1300/ 10 maj 1883; në datë 17 të muajit Rexhep të vitit 1300/ 24 maj 1883, iu akordua medalja *Mexhidije* e klasit të parë, dhe në datë 24 të po atij muaji/ 31 maj 1883 iu akordua medalja *Osmane*, klasi i dytë.

Në datën 26 të muajit Zilhixhe të vitit 1303/ 24 shtator 1886, Vassa Pashës së lartpërmendur Madhëria e Tij, Papa, i dha medaljen e *Shën Gregorit*, klasi i parë.

Në datën 24 të muajit të madhërishëm të Ramazanit të vitit 1304/ 16 qershor 1887, [personit] të lartpërmendur shteti italian i dha medaljen *Corona d'Italia*, klasi i parë.

Në datën 13 të muajit të madhërishëm të Ramazanit të vitit 1306/ 13 maj 1889, pashait të lartpërmendur, duke iu ngritur rang, iu akordua medalja e lartë *Osmane*, klasi i parë.

Në datën 3 të muajit Zilkade të po të njëjtit vit/ 11 shtator 1889, [pashait] të lartpërmendur shteti rus i dha medaljen *Shën Stanisllas*, klasi i parë.

Në datën 23 të muajit Muharrem të vitit 1305/ 11 tetor 1887 iu akorduan medaljet vezulluese më të larta në hierarkinë e medaljeve të arta dhe të argjendta.

* Këtu e njëjta datë jepet sipas dy kalendarëve që përdoren në atë kohë, i pari Hixhri dhe i dyti ai financiar (Rumi).

